



KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

NJOFTIM I DATËS 23.11.2020

PËR SHPREHJE INTERESI

Mbështetur në nenin 147/a, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, nenin 90, pika 1/b, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, në nenin 55, 56, 57, 58 dhe 59, të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, nenin 6, të Ligji nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar” si dhe në Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr. 495, datë 21.10.2020 “Për krijimin e njërive të shërbimit ligjor pranë gjykatave të apelit”, dhe nr. 424, datë 12.10.2020 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të rekrutimit të kandidatit për kancelar, për këshilltar ose për ndihmës ligjor”, me Vendimin Nr. 586, datë 20.11.2020 “Për shpalljen e vendeve vakante në pozicionin e ndihmësit ligjor, në njësinë e shërbimit ligjor në gjykatat e apelit”

Këshilli i Lartë Gjyqësor njofton fillimin e procedurës për emërimin e përkohshëm, në pozicionin e ndihmësit ligjor në gjykatat e apelit, në vendet vakante si më poshtë:

- Në njësinë e shërbimit ligjor në Gjykatën e Apelit Tiranë - 6 ndihmës ligjorë;
- Në njësinë e shërbimit ligjor në Gjykatën e Apelit Durrës - 1 ndihmës ligjorë;
- Në njësinë e shërbimit ligjor në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë - 2 ndihmës ligjorë;
- Në njësinë e shërbimit ligjor në Gjykatën e Apelit Korçë - 1 ndihmës ligjorë;
- Në njësinë e shërbimit ligjor në Gjykatën e Apelit Shkodër - 1 ndihmës ligjorë;
- Në njësinë e shërbimit ligjor në Gjykatën e Apelit Vlorë - 3 ndihmës ligjorë;
- Në njësinë e shërbimit ligjor në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar - 3 ndihmës ligjorë.

Këshilli i Lartë Gjyqësor fton:

Kandidatët për ndihmës ligjorë në gjykatat e apelit, të cilët kanë kaluar me sukses programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, në vitin akademik 2019-2020, të shprehin interesin për pozicionet e lira të shpallur.

Emërimi i përkohshëm bëhet mbi bazë konkurrimi, duke marrë parasysh kriteret e mëposhtme sipas kësaj radhe:

- a) renditjen në listën e kandidatëve;
- b) çdo njohuri ose përvojë të veçantë të kandidatit, që e bën atë veçanërisht të kualifikuar për vendin e lirë;
- c) vitet e përgjithshme të përvojës profesionale në sektorin e drejtësisë ose në pozicione drejtuese.

Në momentin e aplikimit kandidati duhet të paraqesë:

Kërkesën për shprehjen e interesit për të kandiduar në një nga pozicionet e lira të shpallura të ndihmësit ligjor në Njësinë e shërbimit ligjor në Gjykatat e apelit.

Afati i paraqitjes së kërkesës është deri më datë 27.11.2020.

Kërkesa për aplikim duhet të dorëzohet nga kandidati në Zyrën e Protokollit pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, në adresën: Rruga “Ana Komnena”, Godina “Poli i Drejtësisë”, Tiranë.

Pas përfundimit të afatit të kandidimit, lista e kandidatëve për secilin nga pozicionet e lira do të publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Të gjithë të interesuarit për më tepër informacion lidhur me procedurat e kandidimit mund të vizitojnë faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, duke u konsultuar me Vendimin nr. 424, datë 12.10.2020 dhe 586, datë 20.11.2020.

Publikuar më: 23.11.2020